



RAPORTI

I AUDITUESIT TE PAVARUR

MBI PERDORIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA E TE PERDORURA

PER VITIN KALENDARIK 2011

PARTIA "ALENCA ARBNORE KOMBETARE"

Rruga "Besa" nr. 55, afer TV Alsat, Tirane

RAPORTI I AUDITUESIT

Komisionit Qendror te Zgjedhjeve,

Pallati i Kongreseve, Tirane

Të nderuar zotërinj,

Unë, Agim Lleshi, Ekspert Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kam audituar fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin 2011 te partise "Aleanca Arbnore Kombetare".

Deklarimi i Pasqyrave te perfitimit te ketyre fondeve dhe perdorimit te tyre per veprimtarite e ndryshme te subjektit, pasqyrimi kontabel është përgjegjësi e Drejtimit .

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion bazuar në auditimin e kryer, i cili sherben per te dhene nje siguri te arsyeshme per nje pasqyrim te vertete dhe te ndershem te situates financiare te partise, duke perfshire te ardhurat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet.

Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, kryesisht SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga Drejtimi.

Unë cmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opiniononin tim të auditimit.

Auditimi eshte kryer mbi bazen e dokumentacionit te perdorur dhe te gjetur ne zyrat e partise "Aleanca Arbnore Kombetare" per transaksionet ekonomike financiare te kryera gjate vitit kalendarik 2011.

1. Baza ligjore .

Per auditimin e fondeve te perfituara e shpenzuara per vitin 2011 te partise "Aleanca Arbnore Kombetare" jam mbeshtetur, pervec sa me siper, edhe ne :

- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë".
- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar", Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,,

EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR
AGIM LLESHI
ELBASAN
CEL:0692084209

- Cdo akti nenligjor ne zbatim te ligjeve te mesiperm si dhe te cdo dokumenti tjetër te vene ne dispozicion nga partia „Aleanca Arbnore Kombetare”.

2. Statusi i subjektit.

Partia “Aleanca Arbnore Kombetare” eshte krijuar me vendim Nr.9760 date 17.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë. Veprimtaria e saj si organizate politike rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr. 8580, dt.17.02.2000 “Per Partitë Politike”, statutit te saj, etj. Kryetari i partise eshte Z. Gjet Ndoj, i cili ben drejtimin dhe administrimin e saj. Selia e partise „Aleanca Arbnore Kombetare” eshte ne Tirane, Rruga “Besa”, Nr. 55, afer TV Alsat. Partia “Aleanca Arbnore Kombetare” deri tani nuk eshte regjistruar ne organin Tatimor.

. Burimet e financimit jane :

- të ardhurat nga kuotizacionet;
- të ardhurat nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike.
- ndihmat dhe dhuratat e anëtarëve e përkrahësve të partisë.
- ndihmat dhe dhuratat e organizatave partnere.
- cdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

Organet drejtuese të partise janë:

- Kongresi I AAK
- Asambleja e pergjitheshme
- Kryesia e Partise,
- Kryetari I Partise

3. Gjetjet kryesore te Auditimit.

Auditimi i krye ne zbatim te ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë”, Kreu i II-te, Financimi i partive Politike, nenet, 86,87,88,89,90 dhe 91, te cilet legjitimojne per subjektet politike marrjen dhe perdorimin e fondeve publike, fondeve jopublike, regjistrimin dhe shpenzimi i tyre si dhe auditimin e deklarimeve financiare.

- Nga auditimi i kryer ne zbatim te nenit nr. 87 te Ligjit rezulton se per vitin kalendarik 2011 patria „Aleanca Arbnore Kombetare”, nuk ka perfituar financime nga fonde publike sipas rregullave te percaktuara ne Kodin Zgjedhor te RSH. Bashkengjitur raportit te auditimit eshte edhe Deklerata Financiare e vete Subjektit. Gjithashtu nga ana ime u verifikuan keto te dhena me celjen e fondeve te kryera nga Ministria e Financave per llogari te partive politike.
- Nga auditimi i kryer ne zbatim te nenit nr. 88 te Ligjit, nga te dhenat ne dispozicion rezultoi se per vitin financiar 2011, per partine „Aleanca Arbnore Kombetare”, nuk rezultojne fonde publike ne nivel qendror ose vendor apo cdo lloji enti tjetër ku shteti

EKSPERT KONTABEL
 * I AUTORIZUAR *
 ABIM LLESHI
 ELBASAN
 CEL : 0692084209

zoteron kapitale qe te mund te perdoreshin ose te viheshin ne mbeshtetje te kandidateve te ketij subjekti zgjedhor.

- Nga auditimi qe ju krye na zbatim te nenit nr. 89 te Ligjit lidhur me formen dhe permbajtjen te informacioneve specifike rezultoi se per vitin 2011 subjekti nuk ka perfituar fonde jopublike nga persona fizike ose juridike vendas qe te kene kaluar kufirin 100 mije leke, duke respektuar ne kete menyre piken nr. 2 te nenit 89 te Ligjit. Gjithashtu nga verifikimi nuk rezultoi qe subjekti te kete perfituar fonde nga persona juridike apo cdo aksioner i tij, sipas kufizimeve te percaktuara ne piken nr. 3, germa a, b, c, ç te nenit 89 te Ligjit.
- Nga auditimi qe u krye per fondet e perfituara nga kuotat e anetaresise nuk rezultoi qe ndonje anetar te kete derdhur kuoten e anetaresise per vitin 2011, e cila me vone te jete perdorur ne favor te subjektit zgjedhor.
- Nga auditimi i shpenzimeve une nuk konstatova ndonje dokument, fature apo deftese, te kryerjes se ndonje shpenzimi per mirembajtje, sherbime, qera, energji, per reklama ne terren gjate fushates zgjedhore, per mitingje, etj.
- Nga auditimi qe iu krye formes dhe permbajtjes se informacioneve specifike rezultoi se ne gjendjen financiare te subjektit zgjedhor ka sinqeritet. Partia nuk disponon aset. Jane celur librat kontabel dhe regjistri i posacem i subjektit dhe mbahen dokumente baze. Une nuk konstatova ndonje parregullsi, pasaktesi apo shkelje ne zbatim te normave dhe parimeve kontabel si dhe dispozitave te statutit te subjektit.
- Nuk ka ndonje ngjarje apo informacion te mevonshem , ose te rastit qe te kete ndikim ne deklarimet financiare te subjektit zgjedhor per vitin financiar 2011.
- Nga ana ime nuk formulohet ndonje verejtje .

4. Opinion.

Ne perfundim, mbeshtetur ne verifikimet e perfundimet e arritura, shpreh opinionin se deklaratat financiare te perfitimit dhe perdorimit te fondeve qe i bashkengjiten ketij raporti auditimi japin nje pamje te sinqerte e besnike te situates financiare te partise "Aleanca Arbnore Kombetare", duke perfhshire te ardhurat, shpenzimet, asetet, detyrimet, gjendjen pasurore te subjektit ne 31.12.2011.

Tirane date 05/06/2012

Adresa :
Lagjia "28 nentori" Rr. "11 Janar"
Pallati 422/7, kati i II-te
Elbasan
Cel: 0692084209

Ekspert Kontabël të Regjistruar
AGIM LLESHI

EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR
AGIM LLESHI
ELBASAN
CEL: 0692084209